

VENDIM
Nr. 41, datë 24.1.2018

PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

(Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021; nr. 823, datë 28.12.2023; nr. 282, datë 21.5.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Diplomë”, dokumenti zyrtar që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të;
 - b) “Grup-lëndë”, një strukturë akademike dhe administrative organizimi brenda një departamenti, e cila grupon anëtarë të stafit akademik që mbulojnë lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi;
 - c) “IAL”, institucion i arsimit të lartë;
 - ç) “Komponent mësimor”, veprimtari e strukturuar dhe formale mësimore;
 - d) “Laborator”, veprimtaria formuese akademike, gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar, investiguar, observuar dhe provuar teori e metoda të caktuara, të planifikuara brenda një lënde të caktuar, e cila mund të vlerësohet me notë dhe me kredite;
 - dh) “Lëndë”, një degë e një fushe shkencore, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë sistematike gjatë një kohe të caktuar;
 - e) “lëndë individuale artistike/sportive”, një *tërësi komponentësh mësimorë*, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë individuale.
 - ë) “Modul”, një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme, që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë – akademikë që pritet të realizohen nga studenti;
 - f) “Praktikë”, një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me notë kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore;
 - g) “Profil i programit të studimit”, një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore-shkencore brenda një programi studimi, përfundimi me sukses i të cilave e pajis studentin me emërtimin e profilit përkatës brenda diplomës që ofron institucioni i arsimit të lartë;
 - gj) “Provim i përgjithshëm përfundimtar”, një detyrim akademik, përmbledhës i një cikli studimi “Bachelor” ose “Master profesional”, pas kalimit me sukses të të cilit studenti pajiset me diplomën përkatëse;
 - h) “Rezultate të të nxënit”, bashkësi e dijeve, aftësive dhe kompetencave specifike të fushës, që *studenti* duhet të *fitojë* në përfundim të programit të studimit.
 - i) “tema/disertacioni”, një *punim origjinal akademik/kërkimor, nën drejtimin e personelit akademik, që mbrohet përpara një komisioni si detyrimi final për fitimin e diplomës apo gradës shkencore përkatëse, i cili i nënshtrohet kontrollit të plagjiaturës dhe vlerësohet me notë dhe kredite;*
 - j) “master ekzekutiv”, program i ciklit të tretë të studimeve, që ofrohet për profesionistë, sipas kritereve të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë.

2. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga LAL-të, me përjashtim të studimeve të doktoratës, konsistojnë në:

- a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c) rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat profesionale;
- ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
- dh) planin mësimor;
- e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
- ë) programin lëndor (*Syllabus*-et);
- f) profilin e programit;
- g) diplomën dhe suplementin;
- gj) kodin e etikës.

2/1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të doktoratës konsistojnë:

a) Për studimet e doktoratës bartoben projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi të aprovuara dhe me financim të siguruar nga LAL-ja. Pas aktit të hapjes/riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës e certifikimit të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, studentët e pranuar mund të përfitojnë financim sipas ligjit. Njësia bazë mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor për fushën e kërkimit që mbulon;

b) Studimet e doktoratës organizohen në fusha/nënfusha kërkimi. Ato përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore, me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfushën përkatëse të studimit;

c) Në bazë të projekteve kërkimore-shkencore, njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës përcakton numrin e studentëve doktorantë dhe LAL-ja, me vendim të Senatit Akademik, deklaron numrin e doktorantëve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe certifikimin e kapaciteteve akademike e infrastrukturore nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Njësia përgjegjëse e programit të studimeve të doktoratës duhet të garantojë standardet akademike dhe të ofrojë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e projektit kërkimor-shkencor.

ç) Në rregulloren e programit të studimit të doktoratës, njësia bazë:

i. përcakton kriteret e pranimit të studentëve, sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;

ii. bashkërendon, në funksion të realizimit të projektit kërkimor-shkencor, veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe krijuese të studentëve;

iii. parashikon në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të doktoratës;

iv. parashikon në mënyrë të detajuar administrimin e të dhënave të çdo doktoranti lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore e krijuese të tij dhe detyrimin për raportimin e vlerësimit të progresit të doktorantit.

2.1 Kreditet sipas ECTS-së

a) Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.

b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore pune të studentit;

c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë nga një student me kohë të plotë është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) deri në 1 800 (një mijë e tetëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij;

ç) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore vjetore, përveç programeve të studimit në “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji” dhe “Mami”, për të cilat fondi i përgjithshëm i orëve mësimore përcaktohet duke marrë në konsideratë orët minimale mësimore të formimit teorik dhe atij praktik, sipas shtojcës nr. 4, tabela 4.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Ngarkesa mësimore javore në auditor për лексione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor është deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore 50-minutëshe.

dh) Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.

ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.

2.2 Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit

a) Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave.

b) Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e rezultateve të të nxëniet e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.

c) Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të *rezultateve të të nxëniet* dhe të kompetencave profesionale.

ç) Metodatat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e *rezultateve të të nxëniet* e të kompetencave profesionale të programit.

2.3 Rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat profesionale.

a) *rezultatet e të nxëniet* dhe kompetencat profesionale në një program studimi përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit.

b) *rezultatet e të nxëniet* dhe kompetencat profesionale:

i) i atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, si dhe programit të studimit në tërësi;

ii) përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.

iii) vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kriteret e qarta e transparente.

c) *rezultatet e të nxëniet* dhe kompetencat profesionale ndahen në:

i) përcaktues/e, të cilët/të cilat janë të njëjtë/a për programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruar nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë.

ii) specifike/e, të cilët/ të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruara nga IAL të ndryshme. Këta/o *rezultate* e kompetenca përcaktohen veçmas nga secili institucion ofrues i programit të studimi.

ç) *rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat për programet e studimit në "Mjekësi e përgjithshme", "Infermieri", "Stomatologji", "Mami", "Mjekësi veterinarë", "Farmaci" dhe "Arkitekturë" përcaktohen në përputhje me rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat minimale të parashikuara në shtojcën nr. 4, tabela 4.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

2.4 Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit.

a) Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;

ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
iii) përgatitje për provime;
iv) përgatitje e tezës së diplomës;
v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.

b) Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë.

c) Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

2.5 Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi.

a) Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.

b) Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;

ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;

iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;

iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar. Peshë që zë secila lëndë dhe veprimtari formuese brenda programit të studimit:

i. për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë përcaktohen në shtojcën nr. 1, tabela 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. për programet me karakter profesional përcaktohen në shtojcën nr. 1, tabela 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Veprimtaritë formuese mund të jenë:

i) të detyrueshme;

ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

ç) Programet e studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë” hartohen nga IAL-të në përputhje me veprimtaritë formuese minimale, të përcaktuara në shtojcën nr. 4, tabela 4.2.

d) Veprimtaritë formuese grupohen nga institucioni i arsimit të lartë që ofron program studimi të formimit të vazhduar, në bazë të numrit të krediteve të atij programi, si dhe duke iu referuar përcaktimeve në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përsëkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.

2.6 Plani mësimor

Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;

ii) kreditet përkatëse.

2.7 Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore

a) IAL-të përcaktojnë kuotat e lira për regjistrimet e reja të studentëve për çdo program studimi në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe

normativën e përcaktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

b) Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

c) Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose brenda së njëjtës IAL përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë.

ç) *Shfuqizuar.*

d) Numri i studentëve, që përmban grupi mësimor sipas fushës së programit të studimit, përcaktohet në shtojcën nr. 1, tabela nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.8 Modeli i programit të lëndës, që do të përdoret për hartimin e *syllabus*-eve, duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.9 Profili i programit

a) Programi i studimit mund të organizohet në profile, të cilat ofrojnë specializime në drejtime të ngushta të fushës së programit të studimit, në fusha integruese ose ndërdisiplinore të përafërta.

b) Emërtimi i profilit të programit të studimit shënohet në diplomën, që lëshohet në përfundim të tij.

c) *Me vendim të Senatit Akademik, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të bëjë ndryshime profilizuese brenda programit të studimit të akredituar pa ndryshuar emërtimin e programit të studimit. IAL-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik për ndryshimet profilizuese deri në masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS.*

2.10 Diploma/certifikata dhe suplementi i saj

Diplomat/certifikatat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë, si dhe ato të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, shoqërohen me suplementin e diplomës.

2.11 Kodi i Etikës

a) Tërësia e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të cilat kodifikohen në nivel IAL-je ndaj studentëve, personelit akademik dhe atij ndihmësakademik, për t’u sjellë me integritet akademik, mbështetur në ndershmërinë;

b) Elementet e Kodit të Etikës, që prekin aktivitetin studentor, listohen në *syllabus*-e, sidomos për sa i përket detyrimit të studentëve për të mos kopjuar në provime, në punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik e atij mbështetës;

c) *Studimet e doktoratës kanë një kod etike të dedikuar, që specifikon standardet etike të kërkimit, të cilat duhen respektuar, dhe rastet e procedurat kur, si pasojë e thyerjes së Kodit të Etikës, doktoranti mund të përjashtohet nga studimet e doktoratës ose mund t’i revokohet grada shkencore.”.*

2.12 Shfuqizuar.

2.13. Specializimet afatgjata

Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional, që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Elementet e këtyre programeve, sipas fushave, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegës për arsimin.

2.14 Përshtatja nga IAL-të e programeve të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinar”, “Farmaci” dhe “Arkitekturi” me orët minimale të formimit, veprimtaritë formuese, rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat profesionale minimale të parashikuara në shtojcën nr. 4, kryhet jo më vonë se viti akademik 2027–2028.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë,

Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Senida Mesi

SHTOJCË NR. 1

(ndryshuar me VKM nr. 185, datë 25.3.202; ndryshuar fjalë në kategorinë “E” me VKM nr. 282, datë 21.5.2025)

Elementet e programeve të studimit përcaktohen në tabelat 1 dhe 1.1, si më poshtë vijon:

Tabela 1

Kategoria	Komponenti mësimor	Cikli i parë (niveli 6 i KSHK-së)	Cikli i dytë (niveli 7 i KSHK-së)			Cikli i tretë (niveli 8 i KSHK-së)
		<i>Bachelor</i>	Master profesional	Master i shkencave/ master i arteve	Master i shkencave (i integruar)	Master ekzekutiv
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15–20% (kredite)	5–10% (kredite)	5–10% (kredite)	15–20% (kredite)	5–10% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore	50–55% (kredite)	30–40% (kredite)	50–60% (kredite)	45–55% (kredite)	50–60% (kredite)
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/I NTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12–15% (kredite)	20–30% (kredite)	12–20% (kredite)	12–15% (kredite)	12–15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10–15% (kredite)	10% (kredite)	10% (kredite)	6–8% (kredite)	
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3–5% (kredite)	10–20% (kredite)	10–25% (kredite)	3–5% (kredite)	18–20% (kredite)

Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%, në rastin e programeve të ciklit të parë “*Bachelor*” dhe të programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”. Në rastin e programeve të ciklit të dytë “Master i arteve” ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit. Për programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” lëndët e kategorisë B duhet të kenë një karakter dhe orientim të theksuar praktik, me qëllim avancimin e mëtejshëm profesional të studentëve. Për të përmbushur këtë objektiv, lëndët mund të ofrohen në

bashkëpunim me industrinë dhe botën profesionale dhe, për çdo rast, ato duhet të jenë, të paktën, 50% praktikë në terren.

Tabela 1.1

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Programe me karakter profesional (niveli 5 i KSHK-së) 60–120 kredite
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	10–15% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disipinën që karakterizon programin, lëndët praktike	45–55% (kredite)
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	5–15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10–15% (kredite)
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3–5% (kredite)

Shënim. Duhet të ruhet një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50/50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.

SHTOJCË NR. 2

(ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019)

Grupet mësimore në programet e studimit me karakter profesional, të ciklit të parë dhe ciklit të dytë (përfshirë dhe programet e integruara) të studimit, të organizohen me numër maksimal studentësh, si më poshtë:

Tabela 2

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ praktika	Nr. i studentëve/ leksion
Shkenca natyrore	25	20	20	6 grupe seminari
Inxhinieri dhe teknologji	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca agrikuturore dhe të veterinarisë	25	20	20	6 grupe seminari

Shkenca sociale		35	25	25	6 grupe seminari	
Humanitete dhe arte		35	25	25	6 grupe seminari	
Fusha e studimit			Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ leksion	
Shkenca natyrore		20	15	3 grupe seminari		
Inxhinieri dhe teknologji		20	15	3 grupe seminari		
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit		20	15	3 grupe seminari		
Shkenca agrikultur ore dhe të veterinaris ë	20	15			3 grupe seminari	
Shkenca sociale		25	20	3 grupe seminari		
Humanitete dhe arte		25	20	3 grupe seminari		

PËR UNIVERSITETIN E ARTEVE
(BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE TË MËNYRËS SË
MËSIMDHËNIES)

Tabela 2.2

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ Lëndë individuale artistike	Nr. i studentëve/ Mësim artistik në grup	Nr. i studentëve / seminar	Nr. i studentëve/ praktika/shoqërim në piano	Nr. i studentëve / leksion	Nr. i studentëve / laborator
Arte	1	1–15	1–15	1–15	1–6 grupe seminari	1–15

PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE
(BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE MËNYRËS SË
MËSIMDHËNIES)

Tabela 2.3

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ Lëndë individuale në sporte	Nr. i studentëve / seminar teorik	Nr. i studentëve/ leksion	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ laborator (në palestër
Sporte	Jo më shumë se 18	20 – 30	2–6 grupe seminari	20 – 30	jo më shumë se 18

SHTOJCA NR. 3
PROGRAMI I LËNDËS
(ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019)

Emërtimi i lëndës

(Shënim. Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim)

Titullari / /pedagogu i lëndës (për programet profesionale): <i>(emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi)</i> Ngarkesa: <i>(numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)</i> Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Lloji i lëndës: <i>(e detyrueshme ose me zgjedhje)</i> Programi i studimit: <i>(programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)</i> Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
Kodi i Etikës: PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: <i>(Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të përvetësojë në përfundim të lëndës.)</i> KONCEPTET THEMELORE: <i>(Janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda.)</i> 1. 2. 3. ...
TEMAT E LËNDËS <i>(shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe)</i> Tema I – Tema II – Tema III –
FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE FREKUENTIMI: KONTROLI I VAZHDUESHËM: <i>(renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.)</i>
LITERATURA <i>(literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në)</i> a) literatura bazë e detyrueshme: b) literatura e rekomanduar: VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS <i>(hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezervë që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka, si edhe elementet e Kodit të Etikës sipas pikës 2.10 të këtij vendimi)</i>

SHTOJCË NR. 4

(shtuar me Vkm nr. 823, date 28.12.2023)

Tabela 4.1. Parashikime lidhur me rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat që duhet të fitohen në përfundim të programeve të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitektura”

Rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat profesionale	
4.1.1. Formimi bazë për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme”	1. Formimi bazë për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” duhet të sigurojë fitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të përshtatshme për shkencat mbi të cilat bazohet mjekësia dhe kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;

	b) kuptim të mjaftueshëm të strukturës, funksioneve dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore; c) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe praktikat klinike, duke i siguruar studentit një pasqyrë koherente të sëmundjeve mendore dhe fizike, të mjekësisë nga pikëpamja e profilaksisë, diagnostikimit dhe terapisë dhe riprodhimit njerëzor; ç) përvojë të përshtatshme klinike në spitale nën mbikëqyrjen e duhur.
4.1.2 Formimi për programin e studimit “Infermieri”	1. Formimi për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm duhet të sigurojë përfundimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri gjithëpërfshirëse të shkencave në të cilat bazohet infermeria e përgjithshme, duke përfshirë kuptimin e mjaftueshëm të strukturës, funksioneve fiziologjike dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, dhe të marrëdhënies ndërmjet gjendjes së shëndetit dhe mjedisit fizik dhe social të njeriut; b) njohuri për natyrën dhe etikën e profesionit dhe për parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë; c) përvojë të përshtatshme klinike, e cila zgjidhet për vlerën e saj të formimit, nën mbikëqyrjen e personelit të kualifikuar infermior dhe në vendet ku numri i personelit të kualifikuar dhe pajisjet janë të përshtatshme për kujdesin infermior të pacientit; ç) aftësinë për të marrë pjesë në formimin praktik të personelit shëndetësor dhe përvojë pune me këtë personel; d) përvojë pune në bashkëpunim me anëtarë të profesioneve të tjera në sektorin e shëndetësisë. 2. Kualifikimi formal si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm duhet të dëshmojë se profesionisti zotëron të paktën kompetencat e mëposhtme, pavarësisht nëse trajnimi është kryer në universitete, institucione të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent apo shkolla profesionale ose përmes programeve të formimit profesional për infermierinë: a) kompetencën për të diagnostikuar në mënyrë të pavarur kujdesin infermior të kërkuar duke përdorur njohuritë aktuale teorike dhe klinike dhe për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar kujdesin infermior gjatë trajtimit të pacientëve në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara në përputhje me sa parashikohet në këtë Shtojcë; b) kompetencën për të punuar së bashku në mënyrë efektive me aktorë të tjerë në sektorin e shëndetësisë, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnimin praktik të personelit shëndetësor në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara, në përputhje me sa parashikohet në shkronjat “ç” dhe “d”, të nënparagrafit të parë, të pikës 4.1.2, të kësaj shtojce nr. 4; c) kompetencën për të ndërgjegjësuar individët, familjet dhe grupet drejt një stili jetese të shëndetshëm dhe të kujdesit për veten në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara në përputhje me sa parashikohet në këtë pikë 4.1.2, të kësaj shtojce nr. 4; ç) kompetencën për të ndërmarrë në mënyrë të pavarur masa të menjëhershme për ruajtjen e jetës dhe për të zbatuar masa në situata krizash dhe fatkeqësish; d) kompetencën për të dhënë këshilla, udhëzuar dhe mbështetur në mënyrë të pavarur personat që kanë nevojë për kujdes dhe personat e lidhur me ta; dh) kompetencën për të siguruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur cilësinë e kujdesit infermior; e) kompetencën për të komunikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale dhe për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë në sektorin e shëndetësisë; ë) kompetencën për të vlerësuar cilësinë e kujdesit infermior me qëllim përmirësimin gjatë ushtrimit të profesionit si infermier.
4.1.3 Formimi për programin e studimit “Stomatologji”	1. Formimi bazë stomatologjik duhet të sigurojë përfundimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të përshtatshme të shkencave mbi të cilat bazohet stomatologjia dhe një kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave; b) njohuri të përshtatshme për strukturën, fiziologjinë dhe sjelljen e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe ndikimin e mjedisit natyror dhe social në gjendjen e shëndetit të njeriut, për aq sa këta faktorë ndikojnë në stomatologji; c) njohuri të përshtatshme për strukturën dhe funksionin e dhëmbëve, gojës, nofullave dhe të indeve të lidhura me to, të shëndetshme dhe të sëmurë, dhe marrëdhëniet e tyre me gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe me mirëqenien fizike dhe sociale të pacientit; ç) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe metodat klinike, që i ofrojnë stomatologut një pamje koherente të anomalive, lezimeve dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve të lidhura me to, dhe të stomatologjisë

	parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike; d) përvojë e përshtatshme klinike nën mbikëqyrjen e duhur. 2. Ky formim siguron përfitimin e aftësive të nevojshme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve që përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve përkatëse.
4.1.4 Formimi për programin e studimit “Mjekësi veterinarë”	1. Formimi si mjek veterinar duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të përshtatshme të shkencave në të cilat bazohen aktivitetet e një mjeku veterinar dhe të legjislacionit të zbatueshëm në lidhje me këto aktivitete; b) njohuri të përshtatshme për strukturën, funksionet, sjelljen dhe nevojat fiziologjike të kafshëve, si dhe aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për mbarëshkrimin, ushqimin, mirëqenien, riprodhimin dhe higjienën e tyre në përgjithësi; c) aftësitë dhe kompetencat klinike, epidemiologjike dhe analitike të kërkuara për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të kafshëve, duke përfshirë anestezinë, kirurgjinë aseptike dhe vdekjen pa dhimbje, nëse konsiderohen individualisht ose në grup, duke përfshirë njohuritë specifike të sëmundjeve që mund të transmetohet te njerëzit; ç) njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e duhura për mjekësinë parandaluese, duke përfshirë kompetencën për të ndërmarrë inspektime dhe certifikime; d) njohuri të përshtatshme për higjienën dhe teknologjinë e përfshirë në prodhimin, përpunimin dhe vënien në qarkullim të ushqimeve për kafshë ose ushqimeve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor, duke përfshirë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kuptuar dhe shpjeguar praktikatat e mira në këtë drejtim; dh) njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara për përdorimin e përgjegjshëm dhe të arsyeshëm të produkteve medicinale veterinare, me qëllim trajtimin e kafshëve dhe për të garantuar sigurinë e zinxhirit ushqimor dhe mbrojtjen e mjedisit.
4.1.5 Formimi për programin e studimit “Mami”	1. Formimi si mami duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të hollësishme të shkencave në të cilat bazohen aktivitetet e mamive, veçanërisht mamia, obstetrika dhe gjinekologjia; b) njohuri të përshtatshme për etikën e profesionit dhe legjislacionin përkatës për ushtrimin e profesionit; c) njohuri të përshtatshme për njohuritë e përgjithshme mjekësore (funksionet biologjike, anatominë dhe fiziologjinë) dhe farmakologjinë në fushën e obstetrikës dhe të të porsalindurve, si dhe njohuri për marrëdhëniet midis gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore dhe sjelljen e tyre; ç) përvojë të përshtatshme klinike të fituar në institucione të miratuara që i mundëson mamisë të jetë në gjendje, në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e saj, në masën e nevojshme dhe duke përjashtuar situatat patologjike, të menaxhojë kujdesin antenatal, të kryejë pritjen e foshnjës dhe pasojat e saj në institucionet e miratuara; dhe për të mbikëqyrur procesin përpara dhe gjatë lindjes, kujdesin pas lindjes dhe reanimacionin neonatal gjatë pritjes së një mjeku; d) të kuptuarit e duhur të formimit të personelit shëndetësor dhe përvojës së punës me këtë personel.
4.1.6 Formimi për programin e studimit “Farmaci”	1. Formimi për farmacistët duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të përshtatshme për barnat dhe substancat e përdorura në prodhimin e barnave; b) njohuri të përshtatshme për teknologjinë farmaceutike dhe testimin fizik, kimik, biologjik dhe mikrobiologjik të produkteve mjekësore; c) njohuri të përshtatshme për metabolizmin dhe efektet e produkteve mjekësore dhe për veprimin e substancave toksike, si dhe për përdorimin e produkteve medicinale; ç) njohuri të përshtatshme për të vlerësuar të dhënat shkencore në lidhje me barnat në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë informacionin e duhur mbi bazën e këtyre njohurive; d) njohuri të përshtatshme në lidhje me kërkesat ligjore dhe çdo kërkesë tjetër që lidhet me ushtrimin e profesionit të farmacisë.
4.1.7 Formimi për programin e studimit “Arkitekturë”	1. Formimi në fushën e arkitekturës duhet të sigurojë të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të mëposhtme: a) aftësive për të krijuar dizajne arkitekturore që plotësojnë kërkesat estetike dhe teknike; b) njohuri të përshtatshme mbi historinë dhe teorinë e arkitekturës dhe të arteve, teknologjive, dhe shkencave njerëzore përkatëse;

	c) njohjen e arteve të bukura dhe ndikimin në cilësinë e dizajnit arkitekturor; ç) njohuri të përshtatshme për projektimin urban, planifikimin dhe aftësitë e përfshira në procesin e planifikimit; d) të kuptuarit e marrëdhënieve midis njerëzve dhe ndërtesave, dhe midis ndërtesave dhe mjedisit të tyre, dhe nevojës për të lidhur ndërtesat dhe hapësirat ndërmjet tyre me nevojat njerëzore dhe shkallën; dh) të kuptuarit e profesionit të arkitektit dhe rolit të arkitektit në shoqëri, veçanërisht për përgatitjen e informacioneve që marrin parasysh faktorët socialë; e) të kuptuarit e metodave të hulumtimit dhe përgatitjes së përmbledhjes për një projekt arkitektonik; ë) të kuptuarit e projektimit strukturor dhe problemeve ndërtimore dhe inxhinierike që lidhen me projektimin e ndërtesave; f) njohuri të përshtatshme të problemeve fizike dhe teknologjive dhe të funksionit të ndërtesave me qëllim garantimin e komoditetit në brendësi të tyre, si dhe mbrojtjen ndaj kushteve klimaterike në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm; g) aftësitë e nevojshme të projektimit për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të ndërtesave brenda kufizimeve të vendosura nga kostot dhe kuadrit rregullator në fushën e ndërtimit; gj) njohuri të përshtatshme për industrinë, organizatat, rregulloret dhe procedurat e përfshira në përkthimin e koncepteve të projektimit në ndërtesa dhe integrimin e planeve në planifikimin e përgjithshëm.
--	--

Tabela 4.2: Parashikime lidhur me veprimtaritë formuese minimale që duhet të përfshihen në programet e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitektura”

MJEKËSI E PËRGJITHSHME	
4.2.1 Formimi bazë në mjekësi të përgjithshme përbëhet nga të paktën 5 500 (pesë mijë e pesëqind) orë formimi teorik dhe praktik.	
INFERMIERI	
4.2.2 Formimi për përgatitjen e infermierëve përbëhet nga të paktën 4 600 (katër mijë e gjashtëqind) orë formimi teorik dhe klinik, nga të cilat formimi teorik përfshin të paktën një të tretën dhe formimi praktik të paktën gjysmën e kohëzgjatjes së formimit. Institucionet që ofrojnë formimin për infermierinë janë përgjegjëse për koordinimin e formimit teorik dhe klinik përgjatë të gjithë programit të studimit. Formimi klinik përbën atë pjesë të formimit të infermierëve nëpërmjet të cilit praktikanti infermier mëson, si pjesë e një ekipi dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me një individ dhe/ose komunitet të shëndetshëm ose të sëmurë, të organizojë, japë dhe vlerësojë kujdesin e nevojshëm gjithëpërfshirës infermior, në bazë të njohurive, aftësive dhe kompetencave që kanë përftuar. Praktikanti infermier mëson jo vetëm si të punojë në ekip, por edhe si ta drejtojë atë dhe të organizojë kujdesin e përgjithshëm infermior, duke përfshirë edukimin shëndetësor për individë dhe grupe të vogla, brenda institutëve shëndetësore ose në komunitet. Ky trajnim zhvillohet në spitale dhe institucione të tjera shëndetësore dhe në komunitet, nën përgjegjësinë e mësuesve të infermierisë, në bashkëpunim dhe të asistuar nga infermierë të tjerë të kualifikuar. Në procesin mësimor mund të marrë pjesë edhe personel tjetër i kualifikuar. Infermieri praktikant merr pjesë në aktivitetet e departamentit në fjalë për aq sa këto aktivitete i shërbejnë formimit të tij, me qëllim për të mësuar të ndërmarrë përgjegjësitë e përfshira në kujdesin infermior. 4.2.3 Një ose më shumë nga veprimtaritë formuese/lëndëve të mëposhtme mund të ofrohen për mësim si pjesë e disiplinave të tjera ose në lidhje me to. Formimi teorik balancohet dhe koordinohet me formimin klinik në mënyrë të tillë që njohuritë dhe aftësitë e përmendura në këtë shtojcë nr. 4 të fitohen në mënyrë të përshtatshme.	
A. Formimi teorik	B. Formimi klinik
a) Infermieri: - Natyra dhe etika e profesionit; - Parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë; - Parimet e infermierisë në lidhje me: - mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar; - kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar; - kujdesin për fëmijët dhe pediatri;	- Infermieri në lidhje me: - mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar - kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar - kujdesin për fëmijët dhe pediatri; - kujdesin e për nënat dhe fëmijët gjatë shtatzënisë si edhe gjatë e pas lindjes - shëndetin mendor dhe psihiatri;

- kujdesin për nënat; - shëndetin mendor dhe psikiatrinë; - kujdesin për të moshuarit dhe gjeriatrinë. b) Shkenca themelore: - Anatomi dhe fiziologji; - Patologji; - Bakteriologji, virologji dhe parazitologji; - Biofizikë, biokimi dhe radiologji; - Dietetikë; - Higjienë: - mjekësi parandaluese; - edukim shëndetësor; - Farmakologji. c) Shkenca shoqërore: - Sociologji; - Psikologji; - Parime të administrimit; - Parime të mësimdhënies; - Legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; - Aspekte ligjore të infermierisë.	- kujdesin për të moshuarit dhe gjeriatrinë - infermierinë në shtëpi
--	---

STOMATOLOGJI

4.2.4 Formimi për përgatitjen e stomatologëve përbëhet nga të paktën 5 000 (pesë mijë) orë formimi teorik dhe praktik.

4.2.5 Programi i studimeve që çon në lëshimin e dëshmive të kualifikimit formal në stomatologji përfshin të paktën veprimtarinë formuese të mëposhtme. Një ose më shumë nga këto veprimtari formuese mund të ofrohen për mësim si pjesë të disiplinave të tjera ose në lidhje me to.

A. Lëndët bazë	B. Lëndët mjeko-biologjike dhe lëndë të mjekësisë së përgjithshme	C. Lëndët e lidhura drejtpërdrejt me stomatologjinë
- Kimi; - Fizikë; - Biologji.	- Anatomi; - Embriologji; - Histologji, përfshirë citologjinë; - Fiziologji; - Biokimi (ose kimi fiziologjike); - Anatomi patologjike; - Patologji e përgjithshme; - Farmakologji; - Mikrobiologji; - Higjienë; - Mjekësi parandaluese dhe epidemiologji; - Radiologji; - Fizioterapi; - Kirurgji e përgjithshme; - Mjekësi e përgjithshme, përfshirë pediatriinë; - Otorinolaringologji; - Dermato-venereologji; - Psikologji e përgjithshme; - Psikopatologji; - Neuropatologji; - Anestetikët.	- Protetodonci; - Materialet dhe pajisjet dentare; - Stomatologji konservative; - Stomatologji parandaluese; - Anestetikët dhe sedacioni; - Kirurgji speciale; - Patologji speciale; - Praktikë klinike; - Pedodonci; - Ortodonci; - Periodontikë; - Radiologji dentare; - Okluzioni dentar dhe funksionimi i nofullës; - Organizimi profesional, etika dhe legjislacioni; - Aspektet sociale të praktikës dentare.

MJEKËSI VETERINARE

4.2.6 Programi i studimit që çon në lëshimin e dëshmive dhe kualifikimeve formale në mjekësinë veterinare përfshin të paktën veprimtaritë formuese të renditura më poshtë. Mësimi për një ose më shumë nga këto veprimtari formuese mund të ofrohet si pjesë ose në lidhje me veprimtari formuese të tjera.

4.2.7 Formimi praktik mund të jetë në formën e një periudhe trajnimit, me kushtin që ky trajnim të kryhet me kohë të plotë dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të urdhrit profesional përkatës dhe, në mungesë të tij, ministrisë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë, me kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, që përfshihen brenda periudhës së

përgjithshme të formimit prej pesë vitesh studimi. Shpërndarja e formimit teorik dhe praktik midis grupeve të ndryshme të veprimtarive formuese balancohet dhe koordinohet në mënyrë të tillë që njohuritë dhe përvoja të fitohen në një mënyrë që t'u mundësojë veterinerëve të kryejnë të gjitha detyrat e tyre.	
A. Lëndët bazë	B. Lëndët specifike
- Fizikë; - Kimi; - Biologji e kafshëve; - Biologji e bimëve; - Biomatematikë.	a) Shkenca bazë: - Anatomi (përfshirë histologjinë dhe embriologjinë); - Fiziologji; - Biokimi; - Gjenetikë; - Farmakologji; - Farmaci; - Toksikologji; - Mikrobiologji; - Imunologji; - Epidemiologji; - Etikë profesionale. b) Shkenca klinike: - Obstetrikë; - Patologji (përfshirë anatominë patologjike); - Parazitologji; - Mjekësi klinike dhe kirurgji (përfshirë anestetikët); - Leksione klinike për kafshët e ndryshme shtëpiake, shpendët dhe speciet e tjera të kafshëve; - Mjekësi parandaluese; - Radiologji; - Riprodhimi dhe çrregullimet e riprodhimit; - Shërbimi veterinar shtetëror dhe shëndeti publik; - Legjislacioni veterinar dhe mjekësia ligjore; - Terapeutikë; - Propedeutikë. c) Prodhimi i shtazor - Prodhimi shtazor; - Të ushqyerit e kafshëve; - Agronomi; - Ekonomi rurale; - Blegtori; - Higjienë veterinarë; - Etologji dhe mbrojtje e kafshëve. d) Higjiena e ushqimit - Inspektimi dhe kontrolli i produkteve ushqimore shtazore ose ushqimeve me origjinë shtazore; - Higjiena dhe teknologjia e ushqimit; - Praktikë (përfshirë praktikën në vendet ku bëhet therja dhe përpunimi i produkteve ushqimore).
MAMI	
4.2.8 Programi i formimit për mamitë përbëhet nga të paktën 4 600 (katër mijë e gjashtëqind) orë formimi teorik dhe praktik, me të paktën një të tretën e kohëzgjatjes minimale që përfaqëson formimin klinik. 4.2.9 Formimi teorik dhe teknik (pjesa A e programit) balancohet dhe koordinohet me formimin klinik (pjesa B e programit) në mënyrë të tillë që njohuritë dhe kompetencat e përcaktuara në këtë shtojcë nr. 4 të mund të fitohen në mënyrë të përshtatshme. Institucionet që ofrojnë formime për mamitë janë përgjegjëse për koordinimin e teorisë dhe praktikës përgjatë të gjithë programit të studimit. 4.2.10 Formimi klinik zhvillohet në formën e trajnimit të mbikëqyrur gjatë shërbimit në departamentet e spitalit ose shërbime të tjera shëndetësore të miratuara nga autoriteti kompetent. Si pjesë e këtij trajnimi, studentët mami marrin pjesë në aktivitetet e departamenteve përkatëse për aq sa këto aktivitete kontribuojnë në formimin e tyre. Gjatë trajnimit të mbikëqyrur, studentëve u mësohen përgjegjësitë e përfshira në aktivitetet e mamive.	
A. Formimi teorik dhe teknik	B. Formimi praktik dhe klinik
a) Lëndët e përgjithshme: - Anatomi dhe fiziologji bazë; - Patologji bazë; - Bakteriologji bazë, virologji dhe parazitologji; - Biofizika bazë, biokimi dhe radiologji;	Ky trajnim duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e duhur: - Këshillimi i grave shtatzëna, që përfshin të paktën 100 ekzaminime para lindjes. - Mbikëqyrja dhe kujdesi i të paktën 40 grave shtatzëna. - Kryerja e të paktën 40 procedurash lindjeje nga studenti;

- Pediatria, me fokus të veçantë të të porsalindurit; - Higjienë, edukim shëndetësor, mjekësi parandaluese, diagnostikim i hershëm i sëmundjeve; - Të ushqyerit dhe dietetika, me fokus të veçantë të gratë, të porsalindurit dhe foshnjat; - Çështje bazë të sociologjisë dhe çështje socio-mjekësore; - Farmakologji bazë; - Psikologji; - Parime dhe metoda të mësimdhënies; - Legjislacioni i sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore dhe organizimi shëndetësor; - Etika profesionale dhe legjislacioni profesional; - Edukim seksual dhe planifikim familjar; - Mbrojtje ligjore e nënës dhe foshnjës. b) Veprimtari formuese specifike për aktivitetet e mamive - Anatomi dhe fiziologji; - Embriologji dhe zhvillimi i fetusit; - Shtatzënia, lindja dhe puerperiumi; - Patologji gjinekologjike dhe obstetrike; - Përgatitje për lindjen e fëmijës dhe prindërimin, duke përfshirë aspektet psikologjike; - Përgatitje për lindje (përfshirë njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve teknike në obstetrikë); - Analgjezi, anestezi dhe reanimim; - Fiziologji dhe patologji e foshnjës së porsalindur; - Kujdesi dhe mbikëqyrja e foshnjës së porsalindur; - Faktorët psikologjikë dhe socialë.	kur ku ky numër nuk mund të arrihet për shkak të mungesës së grave të disponueshme për të lindur, ai mund të reduktohet në një minimum prej 30, me kusht që studenti të asistojë më tej në 20 lindje të tjera. - Pjesëmarrje aktive në lindje podalike. Kur kjo nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së lindjeve podalike, praktika mund të zhvillohet në një situatë të simuluar. - Kryerja e epiziotomisë dhe hyrje në suturim. Mësimi përfshin formim teorik dhe praktikë klinike. Praktika e suturimit përfshin qepjen e plagës pas një epiziotomie dhe çarjeje të thjeshtë perineale. Kjo praktikë mund të zhvillohet në një situatë të simuluar nëse vlerësohet absolutisht e nevojshme. - Mbikëqyrja dhe kujdesi i 40 grave në rrezik gjatë shtatzënisë, lindjes ose periudhës pas lindjes. - Mbikëqyrja dhe kujdesi (përfshirë ekzaminimin) e të paktën 100 grave pas lindjes dhe foshnjave të porsalindura të shëndetshme. - Vëzhgimi dhe kujdesi i të porsalindurit që kërkon kujdes të veçantë, duke përfshirë të lindurit para kohe, me vonesë, nën peshë ose të sëmurë. - Kujdesi për gratë me sëmundje patologjike në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës. - Hyrje në fushën e kujdesit për mjekësinë dhe kirurgjinë. Mësimi përfshin formim teorik dhe praktikë klinike.
FARMACI	
4.2.11 Gjatë balancimit të formimit teorik dhe praktik për çdo veprimtari formuese, rëndësi e veçantë i jepet aspektit teorik për të ruajtur karakterin universitar të studimit.	
4.2.12 Gjatë ose në fund të formimit teorik dhe praktik, studenti duhet të kryejë një praktikë gjashtëmujore në një farmaci e cila është e hapur për publikun ose në një spital nën mbikëqyrjen e departamentit farmaceutik të atij spitali.	
- Biologji e bimëve dhe e kafshëve; - Fizikë; - Kimi e përgjithshme dhe inorganike; - Kimi organike; - Kimi analitike; - Kimi farmaceutike, përfshirë analizat e produkteve medicinale; - Biokimi e përgjithshme dhe e aplikuar (mjekësore); - Anatomi dhe fiziologji; terminologji mjekësore; - Mikrobiologji; - Farmakologji dhe farmakoterapi; - Teknologji farmaceutike; - Toksikologji; - Farmakognozi; - Legjislacioni dhe, sipas rastit, etika profesionale.	
ARKITEKTURË	
Arkitektura duhet të jetë komponenti kryesor i studimit. Studimi duhet të përmbajë një ekuilibër midis aspekteve teorike dhe praktike të formimit arkitektonik dhe garanton të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të përcaktuara në pikën 4.1.7, të tabelës 4.1, të kësaj shtojce nr. 4.	